



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM
“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI AUDIO
ANALOGE RAJONALE”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 47, datë 07.05.2024 të AMA-s, “Për çeljen e garës për dhënie të licencave të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënie të 1 (një) licence transmetimi audio analoge, të përbërë nga:

- a. licenca e shërbimit të programi audio;
- b. licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarku Elbasan	Petresh	100.6
		Librazhd	90
		Prrenjas	101.2
		Gramsh	96
2.	Qarku Korçë	Tushemisht	104.5
		Çardhak	103
		Ersekë	97.9
3.	Qarku Gjirokastrë	Përmet	90.8
		Gllavë	105.8
		Asim Zenel	97.3
		Këlcyrë	98.8

Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, ***brenda datës 17.06.2024, ora 10:00.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge", e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;
- Pagesat për licencën, tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datë 17.06.2024, ora 10:00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.